



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 1

2003

Janar

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 4, datë 10.1.2003	Për disa shtesa në vendimin nr. 68, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me vendimin nr. 186, datë 3.5.2002 të Këshillit të Ministrave.....	3
Vendim i KM nr. 10, datë 10.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.....	4
Vendim i KM nr. 17, datë 10.1.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në Statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin nr. 42, datë 17.1.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar.....	6
Vendim i KM nr.18, datë 10.1.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore.....	8

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 23.1.2003
Doli nga shtypi më 24.1.2003

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë

VENDIM
Nr. 4, datë 10.1.2003

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.68, DATË 15.2.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE TË
PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, NDRYSHUAR ME
VENDIMIN NR.186, DATË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999, “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.1, të vendimit nr.68, datë 15.12.2001, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen edhe disa standarde dhe kushte teknike, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja

29.SSH UNI 6363	Tuba çeliku, të pasalduar dhe të salduar, për tubacionet e ujit
30.SSH UNI 7091	Tuba të salduar çeliku, të palidhur. Tuba lisho për përdorim të përgjithshëm
31.SSH ISO 4145	Rakorderë çeliku, të palidhur, të filetuar
32.SSH UNI 5745	Veshje me zink në të nxehtë të tubave prej çeliku. Kërkesat dhe provat.
33.SSH UNI 7611	Rakorder polietileni me dendësi të lartë për transportimin e lëngjeve me presion. Karakteristikat.
34.SSH UNI 7612	Tuba polietileni me dendësi të lartë për transportimin e lëngjeve me presion. Llojet përmasat dhe kërkesat
35.SSH UNI 7613	Tuba polietileni me dendësi të lartë. Metodatat e provave.
36.SSH UNI 7616	Tuba polietileni me dendësi të ulët për transportimin e lëngjeve me presion. Karakteristikat.
37.SSH UNI 7990	Tuba polietileni me dendësi të ulët për transportimin e lëngjeve me presion. Llojet, përmasat dhe kërkesat.
38.SSH EN 196.1-6	Metodat e provave të çimentos.
39.SSH EN 197-1	Çimento. Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e përputhshmërisë.
40.SSH EN 197-2	Çimento. Vlerësimi i konformitetit.

VENDIM
Nr.10, datë 10.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federale e Republikës Federale të Jugosllavisë (më poshtë referuar si palët)

Duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre

Kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e dy shteteve palë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit do të hyjnë, në territorin e Shtetit të Palës tjetër pa viza dhe do të qëndrojnë për një periudhë maksimale deri 30 (tridhjetë) ditë.

Neni 2

1) Qytetarët e njërit prej shteteve palë, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të vlefshme, të punësuar në misionet diplomatike ose konsullore dhe organizatat ndërkombëtare, të akredituar në territorin e Shtetit tjetër Palë, do të marrin vizë hyrëse për shtetin pritës para hyrjes në territorin e shtetit pritës me qëllim marrjen e detyrës së tyre. Mbas pranimit të detyrës në misionet diplomatike ose konsullore dhe/ose organizatat ndërkombëtare, këta persona do të jenë të lirë të hyjnë dhe të dalin në territorin e palës tjetër.\2) Dispozitat e paragrafit të parë do të aplikohen për anëtarët e familjeve të tyre, të cilët bashkëjetojnë me ta në të njëjtin vend dhe janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.\

Neni 3

Qytetarët e secilit prej Shteteve Palë do të hyjnë, dalin dhe tranzitojnë në territorin e Shtetit tjetër Palë në çdo pikë kufitare zyrtare për lëvizjen ndërkombëtare.

Neni 4

1. Qytetarët e njërës prej Shtetit Palë, që janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, do të udhëhiqen prej ligjeve dhe rregullave në fuqi të shtetit tjetër Palë gjatë qëndrimit në territorin e këtij Shteti.

2) Kjo marrëveshje nuk kufizon të drejtën e të dy Shteteve Palë të refuzojnë hyrjen, soe të ndalojnë qëndrimin e shtetasve të Palës tjetër në territoret e vet, nëse ata konsiderohen persona të padëshirueshëm (non grata).

Neni 5

1) Me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare, paqen, rendin dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, Shtetet Palë kanë të drejtën të pezullojnë aplikimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht.

2) Shtetet Palë do të informojnë njëra-tjetrën mbi vendimin e pezullimit pjesërisht ose plotësisht të marrëveshjes dhe të rihyrjes në fuqi nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 6

1) Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet respektive të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit tridhjetë 30 (tridhjetë) ditë përpara se kjo marrëveshje të hyjë në fuqi.

2) Shtetet Palë do të informojnë njëri-tjetrin për ndryshimin e këtyre specimeneve, 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se ndryshimet të hyjnë në fuqi.

3) Shtetet Palë do të shkëmbejnë specimenet e reja ose ndryshimet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit duke përfshirë të dhënat e përdorimit të tyre të paktën 30 ditë para se specimenet të jenë paraqitur.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që mund të ngrihen në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo marrëveshje përfundohet për një periudhë të pacaktuar. Secila Palë mund të ndërpresë vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje nëi të ketë njoftuar me shkrim për këtë, Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të shfuqizohet 60 ditë pas datës në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e marrjes së notës së fundit diplomatike me anë të së cilës shtetet kontraktuese, njoftojnë njëra-tjetrën se të gjitha procedurat e nevojshme sipas legjislacionit të tyre të brendshëm për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje kanë përfunduar.

Bërë në Beograd, më 26 nëntor 2002 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëloj të vlefshme. Në rast kontradiktash për interpretimin e marrëveshjes, teksti në anglisht do të ketë epërsi.

VENDIM
Nr.17, datë 10.1.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË STATUTIN E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT, MIRATUARME VENDIMIN NR.42, DATË 17.1.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 18, pikat 1 e 4, të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në statutin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SHTESAT DHE NDRYSHIMET NË STATUTIN E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

1. Në statut fjalët “...zyrave dhe agjencive lokale të punësimit”, të zëvendësohen me “...zyrave rajonale dhe vendore të punësimit, agjencive vendore...”
2. Në nenin 12 emëtimi “...Ministritë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit...” të zëvendësohen me “...Ministritë së Industrisë dhe të Energjetikës...”
3. Në nenin 16 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Në pikën IV fjalët “...të nivelit lokal...” të zëvendësohen me “...në nivel qarku dhe vendor...”
 - b) Në paragrafin e fundit fjalët “...në nivel qendror dhe lokal.” Zëvendësohen me “...në niveo qendror, qarku dhe vendor.”
4. Në paragrafin e dytë të nenit 18, fjalët “...me udhëzim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.” Zëvendësohen me “...nga këshilli administrativ tripalësh.”

“Neni 18/1

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave rajonale dhe vendore të punësimit

Zyra rajonale në nivel qarku ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Menaxhon zbatimin e politikave të punësimit në zyrat vendore të qarkut;
- Propozon forma të reja funksionimi për përsosjen e shërbimeve të punësimit në nivel qarku;
- Jep mbështetje profesionale në kualifikimin e stafit rajonal dhe vendor të shërbimeve të punësimit;
- Organizon punën dhe monitoron zbatimin e detyrave në zyrat vendore;
- Miraton projekte për nxitjen e punësimit, nga të cilat përfitojnë ndërmarrjet e vogla;
- Ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve të miratuara në nivel qarku;
- Planifikon nevojat për trajnim në nivel rajonal;
- Mban regullisht të dhëna për subjektet private, që zhvillojnë veprimtarinë në qarku;
- Planifikon nevojat për trajnim në nivel rajonal;
- Mban rregullisht të dhëna për subjektet private, që zhvillojnë veprimtarinë në qark;
- Bashkërendon ofertën me kërkesën për formim profesional, në nivel qarku;
- Bashkërendon punë e zyrave të punësimit në qark në qendrat publike të formimit profesional, për plotësimin e nevojave për formim që kanë punëkërkuesit e papunë, në përputhje me

kërkesat e tregut të punës;

- Harton, në mënyrë të hollësishme projektbuxhetin e zyrës rajonale dhe e dërgon për miratim në SHKP;

- Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit të zyrës rajonale;

- Harton dhe mbyll bilancet;

- Siguron të dhëna statistikore për programet, shërbimet dhe politikat e punësimit, në nivel qarku;

- Zbaton programin ekzistues statistikor dhe përpunon statistikën e qarkut;

- Propozon përmirësime të treguesve statistikore;

- Bën parashikimin afatshkurtër të tregut të punës, në nivel qarku;

- Jep të dhëna për organet e qeverisjes vendore (qark, komunë, bashki) dhe institucionet e tjera të qarkut, organizon takime dhe bashkëpunon me to, merr pjesë në studime të përbashkëta që i shërbejnë zhvillimit në nivel qarku;

- Njofton Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale për studimet në nivel qarku në fushën e punësimit, të tregut të punës, në shërbimet e punësimit, formimin profesional, nxitjen e punësimit, punët publike etj.

- Regjistron dhe vendos në vendet e punës punëkërkuesit që paraqiten dhe kërkojnë shërbime dhe ndihmën e zyrës së punësimit;

- Ofron shërbime të orientimit profesional, këshillime për punë dhe shërbime të tjera për shtetasit që paraqiten dhe i kërkojnë këto shërbime;

- Zbaton programe të mbështetjeje me të ardhura;

- Zbaton programe shtetërore të tregut të punës, si formim profesional, nxitje të punësimit, punë publike dhe programe të tjera, të ngarkuara me akte, ligjore e nënligjore;

- Bashkëpunon me institucione dhe organizma të tjera, që zbatojnë programe të ndryshme punësimi apo mbrojtjeje sociale;

- Krijon lidhje ndërmjet Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale me qarkun, për harmonizimin e politikave shtetërore të punësimit, në nivel qarku.

Zyra vendore në bashki dhe komunë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Zbaton politikat e punësimit në zyrat vendore;

- Mban rregullisht të dhënat për subjekte private, që zhvillojnë veprimtarinë në nivel vendor;

- Bashkërendon ofertën me kërkesën për formim profesional, në nivel vendor;

- Harton, në mënyrë të hollësishme, projektbuxhetin e zyrës vendore dhe ia dërgon atë zyrës rajonale;

- Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit të zyrës vendore;

- Harton dhe mbyll bilancet;

- Siguron të dhëna statistikore për programet, shërbimet dhe politikat e punësimit, në nivel vendor;

- Zbaton programin ekzistues statistikor dhe përpunon statistikën në nivel vendor;

- Bën parashikimin afatshkurtër të tregut të punës, në nivel vendor, dhe ia dërgon atë zyrës rajonale dhe organeve të pushtetit vendor;

- Regjistron dhe vendos në vendet e punës punëkërkuesit që paraqiten dhe kërkojnë shërbime dhe ndihmën e zyrës së punësimit;

- Ofron shërbime të orientimit profesional, këshillime për punë dhe shërbime të tjera për shtetasit, që paraqiten dhe i kërkojnë këto shërbime;

- Zbaton programe të mbështetjeje me të ardhura;

- Zbaton programe shtetërore të tregut të punës, si formim profesional, nxitje të punësimit, punë publike dhe programe të tjera, të ngarkuar me akte, ligjore e nënligjore;

- Bashkëpunon me bashkitë, komunat, institucionet dhe organizma të tjera, për zbatimin e programeve të ndryshme të punësimi apo të mbrojtjes sociale.”.

VENDIM
Nr.18, datë 10.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE TË SHKENCAVE MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE SHKENCAVE MJEKËSORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federative e Republikës Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje të quajtura si "Palë Kontraktuese");

Duke dëshiruar promovimin e bashkëpunimit në fushën e mjekësisë dhe shkencave mjekësore, Kanë rënë dakord për Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të nxisin dhe zhvillojnë bashkëpunimin mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit reciprok, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë bashkëpunimin në fushat e mëposhtme, të shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore:

- 1) parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve jo-ngjitëse (kardiovaskulare, onkologji, sëmundje të mushkërive, diabeti, traumatologji, etj.);
- 2) parandalimi dhe kontrolli epidemiologjiko-sanitar i sëmundjeve ngjitëse dhe atyre parazitale (AIDS, hepatiti viral, gripi, etj.);
- 3) kontrolli, tregtimi dhe cilësia e barnave;
- 4) kontrolli i shitjes së materialeve narkotike dhe të rrezikshëm;
- 5) informacion mbi teknologjinë dhe shëndetin;
- 6) arsimin shëndetësor dhe trajnime pas-universitare;
- 7) shkëmbim informacioni mbi legjislacionin e ri në fushën e Shëndetësisë;

8) çështje të tjera për të cilat Palët Kontraktuese do të bien dakord.

Neni 3

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion në konferenca ndërkombëtare dhe simpoziume, që do të mbahen në vendet e tyre, që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencat mjekësore.

Neni 4

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- për Republikën Federative të Jugosllavisë – organizata kompetente federale e ngarkuar me punët e Shëndetësisë,

- për Republikën e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë.

Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, do të hartojnë Programet e Bashkëpunimit duke specifikuar format dhe kushtet e bashkëpunimit si edhe kërkesat finciare që rrjedhin prej tyre.

Programet do të hartohen dhe nënshkruhen për një periudhë dy-vjeçare.

Neni 5

Autoritetet kompetente dhe organizatat e Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë revista shëndetësore dhe filma mbi mbrojtjen e shëndetit si dhe materiale të tjera të shkruara, vizuale ose audio-vizuale në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore.

Neni 6

Palët Kontraktuese, në përputhje me interesat reciproke, do të koordinojnë aktivitetet e tyre me OBSH-në (Organizatën Botërore të Shëndetësisë) dhe organizata të tjera ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë.

Neni 7

Amendamentet për këtë Marrëveshje mund të bëhen pas aprovimeve të dhëna nga Palët Kontraktuese.

Neni 8

Marrëveshja do të finalizohet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën që kërkesat sipas legjislacioneve respektive, për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë plotësuar.

Secila nga palët mund ta denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar Palën tjetër me shkrim, për synimin e saj për denoncimin e Marrëveshjes. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së qëni në fuqi brenda 6 muajve nga data e marrjes së njoftimit të fundit.

Firmosur në Beograd më 16 Nëntor 2002 në dy kopje origjinale, në shqip, serbisht dhe anglisht, duke qenë të gjithë tekstet autentike.

Në rast interpretimi të ndryshëm, referimi do t'i bëhet tekstit në anglisht.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

PËR QEVERINË FEDERALE TË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
JUGOSLLAVISË

VENDIM
Nr.26, datë 16.1.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.602, DATË 2.11.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ÇMIMET TAVAN TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR
PËRDORUESIT FAMILJARË DHE JOFAMILJARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995, “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, dhe të neneve 124 e 128, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.602, datë 2.11.2001, të Këshillit të Ministrave, tabela shoqëruese ndryshon dhe zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Tabela e çmimeve tavan të shitjes së energjisë elektrike

Kategoria	Emërtimi	Çmimi në lekë/kWh
	Përdorues familjarë	4.5
	300 kwh e para të muajit	
	Përdorues specialë	
	Furrë buke, prodhim mielli	
	Ujësjiellës, objekte fetare	
	Buxhetore, Hidrovoret	
	Nafta, kromi, bakri	
	Siderurgjia, prodhimi i Çimentos, prodhimi i Plehrave	
	Kimike	
	Përdorues të tjerë	
	Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kv)	
	Furnizimi nga rrjeti TM (6,10 dhe 20 kv)	
	Furnizimi nga rrjeti TU)	

Shënim: Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, ashensor, pompë uji) dot ë faturohet me çmim tavan 4.5 lekë/kWh

VENDIM
Nr. 28, datë 16.1.2003

PËR LIKUIDIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN PETROLEUM CORPORATION” (APC),
SHA, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 264, të ligjit nr.7638, datë 19.1.1992, “Për shoqëritë tregtare” dhe të nenit 13, të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998, “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të ekonomisë dhe Ministrit të Industrisë

dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Likuidimin e shoqërisë “ALBANIAN PETROLEUMCORPORATION”, “APC”, sha, Tiranë, për shkak të pushimit të objektit të shoqërisë, e cila ka ushtruar veprimtari në fushën e hidrokarbureve, nëpërmjet pjesëmarrjes, së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në shoqëritë e kontrolluara, si dhe ka realizuar bashkëpunimin tekniko-financiare të këtyre shoqërisve.

2.Aksionet dhe kuotat e kësaj shoqërie, t’u kalojnë shoqërive “ALBAPETROL”, sha, “ARMO”, sha, “SERVOCOM”, sha,”Uzina Mekanike e Naftës,”shpk, Kuçovë, “Transnafta”, shpk, Patos dhe “Uzina Mekanike”, shpk, Patos.

3.Shoqëria “Albpetrol”, sha, e cila ka si objekt kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, të veprojë si shoqëri aninime më vete.

4.Shoqëria “ARMO”, sha, e cila ka si objekt rafinimin e naftës, shpërndarjen dhe marketingun e produkteve të rafinuara, të veprojë si shoqëri aninime më vete.

5.Shoqëria “SERVCOM”, sha, e cila ka si objekt zhvillimin e shërbimeve gjeofizike, sizmike, shpimin e puseve dhe mirëmbajtjen mekanike të pajisjeve të ndryshme, të veprojë si shoqëri anonime më vete.

6.Aksioneri i vetëm i shoqërisë “ALBPETROL”, sha, “ARMO”, sha, dhe “SERVCOM”, sha, të jetë shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë.

7.Shoqëritë “Uzina Mekanike e Naftës”, shpk, Patos, të veprojnë si shoqëri më vete, ku si ortak i vetëm është shteti, i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë.

8.Të gjitha marrëfeshjet, ku palë është “APC”, sha-ja, t’u kalojnë shoqërive të mësipërme anonime dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar, sipas objekteve përkatëse të këtyre marrëveshjeve.

9.Sistemimi i llogarive financiare dhe i detyrimeve që ka “APC”, sha-ja, të bëhet brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10.Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

11.Vendimi nr.756, datë 26.11.1998, i Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e “ALBPETROL”, sha-së, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 29, datë 16.1.2003

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË “UZINA MEKANIKE”, SHPK, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Shoqëria “Uzina Mekanike”, shpk, Patos t’i nënshtrohet procesit të privatizimit. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë transferimi i së drejtës së pronësisë së pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të saj të tretëve.

2.Struktura e formulës së privatizimit, për transferimin e së drejtës së pronësisë së pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të saj të tretëve.

a)Struktura e formulës së privatizimit, për transferimin e së drejtës së pronësisë së pjesëve të barabarta të kapitalit të shoqërisë, të jetë si më poshtë vijon:

b)Ish-pronarëve të trualit t’u afrohen pjesë të barabarta të kapitalit, përllogaritur sipas vlerës së këtij trualli, të përfshirë në kapitalin themeltar të shoqërisë, në mbështetje të akteve, ligjore dhe

nënligjore, në fuqi.

c) Punonjësve të shoqërisë t'u afrohen pjesë të barabarta të kapitalit në shkëmbim të vlerës së bonove të privatizimit, dhënë atyre nga shteti. Madhësia e kësaj pakete nuk mund të jetë më e madhe se 20 për qind e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Punonjës të "Uzinës Mekanike", shpk, Patos, quhen punonjësit efektivë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe punonjësit e kësaj shoqërie, të dalë në asistencë me vendimet nr.422, datë 9.7.1998, e nr.372, datë 27.5.2001, të Këshillit të Ministrave.

3.Procedurat e privatizimit të shoqërisë të bëhen në mbështetje të vendimit nr.119, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë".

4.Formula e privatizimit të pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të shoqërisë të përcaktohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë.

5.Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.30, datë 16.1.2003

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË "TRANSNAFTA", SHPK, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare", me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe të ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Shoqëria "Transnafta" shpk, Patos, t'i nënshtrohet procesit të privatizimit. Forma e privatizimit të shoqërisë të jetë transferimi i së drejtës të pronësisë të pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të saj, të tretëve.

2.Struktura e formulës së privatizimit për transferimin e së drejtës së pronësisë të pjesëve të barabarta të kapitalit të shoqërisë të jetë si më poshtë vijon:

a)Jo më pak se 51 për qind e pjesëve të barabarta të kapitalit të ofrohen për t'u shitur në lekë. Sasia e mësipërme e pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të transferohet nëpërmjet shitjes në ankand.

b)Ish-pronarëve të truallit t'u ofrohen pjesë të barabarta të kapitalit, të përlllogaritura sipas vlerës së këtij trualli të përfshirë në kapitalin themeltar të shoqërisë, në mbështetje të akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi.

c)Punonjësve të shoqërisë u ofrohen pjesët e barabarta të kapitalit në shkëmbim të vlerës së bonove të privatizimit, të dhëna nga shteti. Madhësia e kësaj pakete nuk mund të jetë më e madhe se 20 për qind e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Punonjës të "Transnafta" shpk, Patos, quhen punonjësit efektivë në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe punonjësit e kësaj shoqërie, të dalë në asistencë, me vendimet nr.422, datë 9.7.1998 e nr.372, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave.

3.Procedurat e privatizimit të shoqërisë të bëhen në mbështetje të vendimit nr.119, datë 18.3.2000, "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë".

4.Formula e privatizimit të paketave të pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar të shoqërisë, të përcaktohet me urdhër të ministrit të Ekonomisë.

5.Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.31, datë 16.1.2003

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT, ME KONCESION TË FORMËS “BOO”,
TË HIDROCENTRALIT TË URAKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, i ndryshuar me propozimin e ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- 1.Fillimin e procedurës së ndërtimit, me koncesion, të hidrocentralit të Urakës, në komunën e Rajcë-Librazhd nga shoqëria “Skraqi” shpk, Elbasan, sipas propozimit të pakërkuar.
 - 2.Koncesioni të jetë i formës “Boo” (ndërtim, pronësi, shfrytëzim).
 - 3.Autorizimin e Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës si organ shtetëror i autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës koncesionare.
 - 4.Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.32, datë 16.1.2003

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRTIMIT, ME KONCESION, TË FORMËS
“BOO”, TË HIDROCENTRALEVE NË TËRNOVË DHE ZALLI I BULQIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- 1.Fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të hidrocentraleve, në Tërnovë dhe Zalli i Bulqizës nga shoqëria “Teodori”, shpk, Tiranë, sipas propozimit të pakërkuar.
 - 2.Koncesioni të jetë i formës “Boo” (ndërtim, pronësi, shfrytëzim)
 - 3.Autorizimin e Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës si organ shtetëror i autorizuar (OSHA) për negocimin dhe nënshkrimin e kontratës koncesionare.
 - 4.Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.42, datë 16.1.2003

**PËR KRIJIMIN E KOMITETIT NDËRSEKTORIAL, PËR ZBATIMIN E PLANIT
KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR MJEDISIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76, të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e ministrit të Mjedisit Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Krijimin e Komitetit Ndërsektorial, për bashkërendimin e angazhimeve të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, për zbatimin e Planit Kombëtar të veprimit për Mjedisin.

2.Komiteti Ndërsektorial të kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të ketë:

- ministrin e Mjedisit	Nënkryetar
- ministrin e Financave	anëtar
- ministrin e Bujqësisë dhe të Ushqimit	anëtar
- ministrin e Industrisë dhe të Energjetikës	anëtar
- ministrin e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit	anëtar
- nënkryetarin e Akademisë së Shkencave	anëtar
- zëvendësministrin e Ekonomisë	anëtar
- zëvendësministrin e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit	anëtar
- zëvendësministrin e Transportit dhe të Telekomunikacionit	anëtar
- zëvendësministrin e Shëndetësisë	anëtar
- zëvendësministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	anëtar
- zëvendësministrin e Rendit Publik	anëtar
- drejtorin e INSTAT-it	anëtar
- zëvendësministrin e Mjedisit	sekretar

Ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga OJF-të e mjedisit dhe nga organizatat profesionale të biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Vendim i KM nr. 26, datë 16.1.2003	Për një ndryshim në vendimin nr. 602, datë 2.11.2001 të Këshillit të Ministrave “Për çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike, për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë”	10
Vendim i KM nr. 28, datë 16.1.2003	Për likuidimin e shoqërisë “Albanian Petroleum Corporation” (APC) sh.a., Tiranë.....	11
Vendim i KM nr. 29, datë 16.1.2003	Për privatizimin e shoqërisë “Uzina mekanike” sh.p.k., Patos	12
Vendim i KM nr. 30, datë 16.1.2003	Për privatizimin e shoqërisë “Transnafta” sh.p.k., Patos.....	12
Vendim i KM nr. 31, datë 16.1.2003	Për fillimin e procedurës së ndërtimit, me koncesion të formës “BOO”, të hidrocentralit të Urakës.....	13
Vendim i KM nr. 32, datë 16.1.2003	Për fillimin e procedurës së ndërtimit, me koncesion, të formës “BOO”, të hidrocentraleve në Tërnovë dhe Zalli i Bulqizës.....	14
Vendim i KM nr. 42, datë 16.1.2003	Për krijimin e Komitetit Ndërsektorial, për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimeve për Mjedisin.....	14
	<i>Vendim i shkurtuar për shpallje të zhdukur të shtetasit Bashkim Gorovelli.....</i>	15